



**BASHKIA
TIRANË**
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.84, datë 27.07.2020

“PËR

SHTYRJEN E AFATIT TË DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT PËR FAZËN E DYTË TË PROGRAMIT SOCIAL TË STREHIMIT “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË” I FINANCUAR ME FONDET E BUXHETIT TË SHTETIT”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; nenit 113, të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimit nr. 9, datë 05.02.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “Subvencionimi i Interesave të Kredisë”, i financuar me fondet e Buxhetit të Shtetit”, si dhe në vijim të Memos me nr. 23146 datë 13.07.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Shtyrjen e afatit të dorëzimit të dokumentacionit për fazën e dytë të programit social të strehimit “Subvencionimi i interesave të kredisë” financuar me fondet e Buxhetit të Shtetit, për një periudhë prej 30 ditësh, nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, përtej afatit të parashikuar në Udhëzuesin Operacional miratuar me vendimin nr. 9, datë 05.02.2020 të Këshillit Bashkiak.
2. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, Njësitë Administrative dhe Lagjet për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

